

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2017-2027

Draft- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore
2017-2027

Mbi Strategjinë:

(Draft) Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2017-2027 (SKMIBU) është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumentave të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik dhe përmban edhe dokumente të tjera përkatëse.

Draft Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SMIBU) është përgatitur nga konsulenti Mott MacDonald, në bashkëpunim me Abkons dhe GR Albania, i financuar nga Banka Botërore dhe SIDA.

Menaxhimi i integruar i burimeve ujore në vend do të arrihet nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor, ekonomik, institucionale, teknike dhe sociale duke u bazuar në legjislacionin Evropian për mjedisin dhe parimet e MIBU-s.

Proçesi i zhvillimit të Strategjisë MIBU për Shqipërinë është hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një kornizë për administrimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore, në të cilin të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetet përdoruese, pavarësisht nga gjinia, të luajnë një rol aktiv.

Strategjia integron objektivat e politikave ekzistuese shqiptare duke marrë parasysh rreziqet që pritet të vijnë nga ndryshimet klimatike bazuar në katër 'shtylla' strategjike: 'Ujë për Njerëzit', 'Ujë për Ushqim', 'Ujë për Industrinë', dhe 'Ujë për Mjedisin'.

Strategjia MIBU përcakton 5 Objektiva Strategjike që kërkojnë një vëmendje të veçantë:

- 1. Sasia e Ujit:** sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm të të gjitha burimeve ujore, që i shërben të gjitha interesave nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;
- 2. Cilësia e Ujit:** sigurimi i një cilësie të mirë të ujit të të gjitha burimeve ujore, duke arritur statusin e "gjendjes së mirë të ujit" deri në vitin 2027, nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;

3. **Rreziqet nga Uji:** ulja e rreziqeve që vijnë nga uji (përmytjet dhe thatësitrat) përmes menaxhimit dhe investimeve, që i shëben të gjitha interesave nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;
4. **Informacion për Ujin:** sigurimi i modeleve dhe të dhënave të njohura gjerësisht si të besueshme rreth ujit dhe klimës për të gjitha palët e interesit dhe dhënia e këshillave qeverisë për hartimin e politikave për ujin duke u bazuar mbi këto të dhëna dhe modele;
5. **Administrimi i Ujit:** menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në shërbim të gjitha interesave duke ofruar përfitime social-ekonomike të barabarta nga përdorimi i ujit dhe përfshirje në vendimmarrje për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore MIBU dhe të BE-së.

Rezultatet kryesore të pritshme përfshijnë:

- Përdorim dhe shpërndarje të ujit në mënyrë efikase dhe të barabartë dhe një rritje thelbësore në efikasitetin e përdorimit të ujit në të gjithë sektorët me qëllim shfrytëzimin, riciklimin dhe ripërdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore;
- Ulje të ndotjes nëpërmjet moslejimit të shkarkimeve të paligjshme dhe kufizimit të shkarkimeve të lëndëve kimike të rrezikshme në trupa ujorë (niveli i saktë i uljes do të jetë në funksion të numrit dhe natyrës të këtyre shkarkimeve);
- Rritjen e qëndrueshmërisë dhe aftësisë për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve që vijnë nga katastrofat natyrore;
- Një njohje të thellë të të gjitha burimeve ujore në Shqipëri, duke ofruar kështu një bazë njohurish publike për vendimet (politikat) lidhur me menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
- Politika të qarta MIBU dhe zbatim të PMBU-së që synon a) objektiva të matshme në afate kohore të caktuara, në nivele të duhura, dhe b) përcaktimin e qartë të përgjegjësitë autoriteteve, duke u bazuar në një monitorim dhe vlerësim efikas.

Baza Ligjore

Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore për Shqipërinë është zhvilluar në përputhje me:

- Nenin 16 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Ujit”, i cili deklaron se:
 - Strategjia MIBU është një dokument planifikues që parashtron vizionin e politikave shtetërore, misionin, qëllimet dhe objektivat në fushën e menaxhimit të integruar të ujit në një kohë afatgjatë;
 - Strategjia MIBU duhet të bazohet mbi kërkime shkencore, monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes dhe fenomeneve që lidhen me ujin dhe përdorimin e tij, duke vlerësuar problemet specifike dhe të Integruara të ujit dhe mbrojtjes mjedisore në çdo basen ujor;

- Strategjia MIBU është një dokument kuadër për zhvillimin e planeve të menaxhimit të ujit dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes mjedisore, biodiversitetit, peisazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, si dhe përfshin shëndetin publik dhe dokumente të tjera përkatëse;
- Strategjia MIBU duhet të rishikohet çdo 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, por mund të rishikohet dhe përditësohet përpara përfundimit të kësaj periudhe, nëse një veprim i tillë diktohet nga ndryshime në sistemin ujor dhe zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit;
- Organet, entet, institucionet që janë përgjegjëse për ujin, do të jenë përgjegjëse për krijimin e Strategjisë MIBU nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit;
- Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 1, (17.02.2015), ‘Mbi përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Kombëtare të Ujit, Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore, dhe Planeve të Menaxhimit për Rrezikun nga Përmytjet’;
- Ligjin Kombëtar për barazinë gjinore në shoqëri (Nr. 997/24.07.2008) i cili krijoi kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen kundër të gjitha llojeve të diskriminimit gjinor dhe promovimin e mundësive të barabarta. Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare dhe planin për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri;
- Urdhrin e Kryeministrit Nr. 93 (07.08.2012) që përshkruan Strukturën për Dokumentet Strategjike Sektoriale dhe Ndërsektoriale si më poshtë:
 - Kapitulli 1: Kushtet Aktuale;
 - Kapitulli 2: Vizionet, Politikat dhe Objektivat Strategjike;
 - Kapitulli 3: Objektivat e Politikave dhe Rezultatet Kryesore;
 - Kapitulli 4: Burimet Financiare;
 - Kapitulli 5: Llogaridhënia, Monitorimi dhe Analiza e Vlerësimit.

Kjo strategji është e vlefshme për një periudhë dhjetëvjeçare: nga viti 2017 (*data e përlllogaritur e miratimit në Këshillin e Ministrave*) deri në vitin 2027 dhe do t’i nënshtrohet përditësimit çdo dy vjet, me rishikim të ndërmjetëm në vitin 2022 (ose një date tjetër të përcaktohet kohe pas kohe në përputhje me programet e zbatueshme)

Konsultimi i draft Strategjisë

Të gjitha palët e interesit janë ftuar për të marrë pjesë në një sërë takimesh për t’u informuar lidhur me prezantimin e projektit për përgatitjen e strategjisë kombëtare për menaxhimin e interguar të burimeve ujore.

Gjithashtu është bërë edhe publikimi në media i draft Strategjisë.

Të gjitha njoftimet dhe ftesat e palëve të interesit në nivel kombëtar janë organizuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimi Rural dhe Administrimi i Ujërave.

Gjithashtu janë organizuar edhe takime në nivel qarku/rrethi, intervista me informuesit kyc dhe fokus grupe, me qëllimin identifikimin e ndikimit të projektit në jetën dhe aktivitetet e tyre të përditshme.

Në faqen e internetit të projektit: www.iwrm.al janë ftuar dhe u është dhënë mundësia cdo aktori dhe pale të interesit për të dhënë komente dhe sugjerime në faqen e internetit, e cila është lidhur drejtpërdrejtë me adresën e e-mailit të ministrisë dhe të konsulentit.

Mbyllja e projektit

Projekti për përfundimin e dokumentit të Strategjisë së MIBU përfundoi në datën 23 dhjetor 2016.

Dokumentat e përgatitura nga Konsulenti

Konsulenti, në përputhje me termat e referencës së kontratës, ka përgatitur këto dokumenta:

- ✚ Raportin Fillestar
- ✚ Raportet dhe dokumentet e diskutimit për ëorkshopet njëditore
- ✚ Raportet e Grupeve të Punës
- ✚ Drafti i Strategjisë MIBU
- ✚ Strategjia Përfundimtare MIBU
- ✚ Propozimi për Zhvillimin e Kapaciteteve
- ✚ Plani i Shpërndarjes Publike
- ✚ Forumi i Palëve të Interesit
- ✚ Aktivitetet për Zhvillimin e Kapaciteteve

